



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ**

---

Numri i lëndës: 2022:246687

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05491725

CP.nr.143/2013

GJYKATA THEMELORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Hajrullah Aruqi me bashkëpunëtorin profesional Agron Geci, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A, tani Telekom i Kosovës -Vala, me seli në Prishtinë, ndaj debitorit N.M., me nr. personal..., me vendbanim në Skenderaj, Rr..., për borxh në shumën prej 32.88 euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 22.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

PËRFUNDOHET procedura përmbarimore e kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A, tani Telekom i Kosovës -Vala, me seli në Prishtinë, ndaj debitorit N.M., me vendbanim në Skenderaj, Rr..., për borxh në shumën prej 32.88 euro (tridhjetë e dy euro e tetëdhjetë e tetë cent), për shkak të pagesës së borxhit në tërësi nga debitori.

**A r s y e t i m**

Gjykata me Aktvendimin CP.nr.143/2013 me dt.12.06.2013 e ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A.-Vala me seli në Prishtinë, ndaj debitorit N.M., me vendbanim në Skenderaj, Rr..., për borxh në shumën prej 87.88 euro, ndërsa me parashtrësën e dt.26.02.2024 kreditori e bëri precizimin e borxhit, ku theksuan se borxhi aktual i debitorit është në shumën prej 32.88 euro.

Debitori e ka njoftuar gjykatën se e ka përmbaruar borxhin në tërësi, kjo dëshmohet përmes dëftesave të lëshuara nga Telekom i Kosovës nr.73245515 e dt.22.03.2024 e cila është në

shumën prej 32.88 euro, si dhe taksën gjyqësore në shumën prej 15 euro me numër të pagesës 19291837-2024-Skenderaj, e lëshuar nga Posta e Kosovës dt.22.03.2024.

Gjykata duke u bazuar në nenin 66 par.4 të LPP-së, në të cilin është përcaktuar se “Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxjerret vendim për përfundimin e procedurës përmbartimore”, andaj nga të lartcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM  
CP.nr.143/2013, me dt.22.03.2024

Gjyqtari  
Hajrullah Aruqi

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditor nga dita e pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.